



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HIMARË

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: [bashkiahimare@yahoo.com](mailto:bashkiahimare@yahoo.com)  
Nr Prot 2177 Himare : 21 / 07 /2017

### N J O F T I M

Ju veme ne dijeni se bazuar ne Vendimin nr.231 date 21.03.2017 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr.408 , date 13.05.2015 , te Keshillit te Ministrave, "Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit", te ndryshuar ;

Nderhyrjet e meposhtme kryhen pa pajisje me Leje Ndertimi dhe pa paraqitur Deklarate Paraprake Punimesh :

- a) Ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, sipas nenit 2, të kësaj rregulloreje, që përfshijnë:  
i) ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinalë të tyre, si vijon:  
- rifreskimi i lyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjtë me ato ekzistuese;  
- pastrimi i fasadave;  
- riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tillë si forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente;  
- zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes;  
- riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve dhe oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme;  
- riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;  
- vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;  
- vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;  
- lëvizja e shtresave të sipërme të oborreve;  
- riparimi i rrithimeve ekzistuese. ii) ndërhyrje të brendshme:  
- riparimi dhe rinasimi i dyshemeve;  
- riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave;  
- riparimi dhe rinasimi i dyerve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave të dyfishtë.  
iii) ndërhyrje në impiante higjeno-sanitare:  
- veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit;
- b) Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuar;
- c) Lëvizjet e dheut që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimitarisë bujqësore ose blegtore, përfshirë ndërhyrjet në impiante hidraulike bujqësore.

Jorgo Goro  
K R Y E T A R

